



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:036237

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05760170

KE.nr.88/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit PRADA S.A. 23, me seli në Luxembourg, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xhevdet Rama, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit "MEGKOS TRANS" SH.P.K., me NUI: 811908518, me seli në rrugën "Vasil Andoni" nr.17, në Prishtinë, me objekt kontesti Shkelje e markës tregtare, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datën 22.05.2024, në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit PRADA S.A. 23, dhe VËRTETOHET se i padituri "MEGKOS TRANS" SH.P.K., me datën 20.01.2023 përmes importimit të 90 copë jelek për të rritur, ka shkelur markat tregtare të regjistruara të paditësit "PRADA.
- II. I NDALOHET të paditurit që në të ardhmen të ndërmarrë çfarëdo veprimi me të cilin mund të shkelen të drejtat e pronësisë intelektuale të paditësit në çfarëdo mënyre, duke përfshirë importimin që përmbajnë elemente identike apo të ngjajshme me markat tregtare të regjistruar të paditësit.
- III. MBETET në fuqi masa siguroese e lëshuar me Aktvendimin KE.nr. 88/23 të datës 16.02.2023, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.
- IV. DETYROHET i padituri që paditësit të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 812 € (tetëqind e dymbëdhjetë euro), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Paditësi PRADA S.A. 23, përmes të autorizuarit të tij, me datën 02.02.2023, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, për shkelje të markës tregtare kundër të paditurit “MEGKOS TRANS” SH.P.K., me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të vërtetohet se: I padituri me importimin e 90 jeleka për të rritur, ka shkelur markat tregtare të paditësit Prada; të i ndalohe të paditurit që të kryej shkeljen e markave tregtare të paditësit PRADA; të urdhërohet Dogana e Kosovës të mbajë në ndalim mallrat sipas listë distribuimit sipas rastit doganor 39-2023 nga data 20.01.2023 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit si dhe të obligohet i padituri që paditësit t’i paguaj në tërësi shpenzimet e procedurës kontestimore.

Në referatin e padisë, ka theksuar që i padituri ka importuar mallra të shënjuara me shenjat e ngjajshme dhe të njëjta sikur të paditësit, me ç’rast me datën 20.01.2023, nga Dogana e Kosovës, janë ndaluar mallrat – 90 copë jelek për të rritur, ndërsa me datën 30.01.2023 bartësi i të drejtës ka konfirmuar që mallrat e ndalura, nuk janë mallra origjinale dhe shkelin të drejtat e paditësit të mbrojtura sipas LMT-së.

I autorizuari i paditësit avokati Xhevdet Rama, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka bërë precizimin e kërkesëpadiës dhe ka hequr dorë nga kërkesa që të urdhërohet Dogana e Kosovës që të i mbaj mallrat në ndalim sipas listës së distribuimit 39-2023 të datës 20.01.2023, duke shtuar që nga provat e administruara dhe deklaratimet në padi vërtetohet se i padituri ka shkelur markën tregtare të mbrojtur të paditësit.

I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Gjykata lidhur me këtë çështje juridike, ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datën 22.05.2024, në të cilën seancë ka qenë i pranishëm përfaqësuesi i autorizuar i paditësit avokati Xhevdet Rama, ndërsa nuk ka qenë i pranishëm i padituri, i cili ftesën për seancë e shqyrtimit kryesor e ka pranuar në mënyrë të rregullt me datën 10.05.2024, mirëpo në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjykata me propozimin e përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse në bazë të nenit 423 par. 4 të LPK-së, i cili përcakton se *“Po që se në seancën për shqyrtim kryesor nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht, atëherë shqyrtimi kryesor i çështjes bëhet pa praninë e tij”*, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në mungesë të palës së paditur.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër 8097 numër aplikimi KS/M/2008/540, të datës 08.05.2008; Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër 8098 numër aplikimi KS/M/2008/541, të datës 08.05.2008; Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër 8099 numër aplikimi KS/M/2008/542, të datës 08.05.2008; Liste distribuimi – njoftim nga Dogana e Kosovës – rasti 39-2023 Prada, i datës 20.01.2023; si dhe Deklarata e datës 30.01.2023.

Deklarimet e paditësit si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas Vendimit për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër 8097 numër aplikimi KS/M/2008/540, të datës 08.05.2008, vërtetohet se paditësi ka të regjistruar pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale dhe është pronar i markës tregtare verbale “PRADA” dhe bartës i të drejtës së markës tregtare për produktet dhe shërbimet nga Klasat 3,9, 18 dhe 25 e Klasifikimit të Nicës.

Sipas Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër 8098 numër aplikimi KS/M/2008/541, të datës 08.05.2008, vërtetohet se paditësi ka të regjistruar pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale dhe është pronar i markës tregtare figurative të shenjës “PRADA S.A.” dhe bartës i të drejtës së markës tregtare për produktet dhe shërbimet nga Klasa 3,9, 18 dhe 25 të Klasifikimit të Nicës.

Sipas Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër 8099 numër aplikimi KS/M/2008/542, të datës 08.05.2008, vërtetohet se paditësi ka të regjistruar pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale dhe është pronar i markës tregtare verbale “MIU MIU” dhe

bartës i të drejtës së markës tregtare për produktet dhe shërbimet nga Klasat 3,9, 18 dhe 25 të Klasifikimit të Nicës.

Sipas Njoftimit nga Dogana e Kosovës - Rasti 39-2023 PRADA, të datës 20.01.2023 vërtetohet se mallrat kontestuese të paditurit janë ndaluar nga Dogana nën dyshimin për shkelje të se drejtës së markave tregtare të paditësit.

Sipas Deklaratës se datës 30.01.2023, vërtetohet se mallrat kontestuese të paditurit përmbajnë shenjën identike me markat tregtare të regjistruara të paditësit dhe nuk janë produkte origjinale apo të prodhuara nga bartësi i së drejtës.

Gjykata pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, sepse shenja që është përdorur në produktet e të paditurit është identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijoj bindjen se bëhet fjalë për produktet e paditësit.

Sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-075 për Markat Tregtare (LMT) i aplikueshëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Bartësi i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me regjistrimin e markës tregtare. Sipas LMT, bartësi i markës së regjistruar tregtare ka drejta të: ndalojë përdorimin e paautorizuar të markës tregtare të tij përmes mjeteve juridike në dispozicion, të përdorë markën e regjistruar në tregun e Kosovës, si dhe të disponojë me markën tregtare të tij. Mbajtësi i një marke tregtare sipas nenit 9 të LMT-së, ka të drejtë të ndalojë: vendosjen e markës së mbrojtur, në mallra, në paketim ose etiketat e mallit; ofrimin e mallrave, vendosjen e tij në treg apo ruajtjen e tij për këto qëllime, apo ofrimin e shërbimeve nën markën tregtare të tij; importimin, eksportimin ose transitin e mallrave nën markën tregtare dhe përdorimin e markës së mbrojtur në dokumentet zyrtare ose për reklama.

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj, përbën shkelje të markës tregtare. Sipas nenit 9 të LMT-së, shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njëjërën prej të drejtave të pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton si jokontestues fakti se importimi i mallrave kontestuese nga i padituri, të cilat nuk janë mallra të prodhuara nga paditësi, e në të cilat mallra është përdorur shenja identike me markat tregtare të regjistruara të paditësit, përbën shkelje të markës tregtare.

Prandaj duke u nisur nga të sipër cekurat dhe nga fakti se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, gjykata ka konstatuar se i padituri përmes importimit të mallrave: 90 copë jelek për të rritur me datën 20.01.2023, ka shkelur markat tregtare të paditësit të regjistruara sipas numrave 8097, 8098 dhe 8099.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi dhe atë: për përpilimin e padisë në kontestet me element të huaj shumën prej 200.00 €, për taksë gjyqësore shumën prej 72.00 € dhe përfaqësim në dy seanca gjyqësore shumën prej 540 € (2x270), në shumë të përgjithshme prej 812.00 €.

Nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.88/23, datë 22.05.2024

Numri i lëndës: 2024:036237  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05760170

Gjyqtari  
Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.